



BASHKIA TIRANW
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 32, datë 23.05.2016

Për

“KALIMIN E DISA PRONAVE NË ADMINISTRIM TË TIRANA PARKING”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat “a” dhe, pika 1/1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 23, pikat 4 dhe 6, dhe nenit 55, pikat 2 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 11 dhe nenit 12, shkronja “c” të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); nenit 3 të ligjit Nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 143, datë 18.01.2012 për “Miratimin e listës paraprake (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tiranë, të qarkut të Tiranës”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 650, datë 31.07.2013, për “Miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e tretë, e katërt dhe pestë) të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë e Tiranës, të Qarkut të Tiranës”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.714, datë 28.08.2013, për “Kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr. 1/242, ndërtesë, me sipërfaqe 801.4 m², pasurisë nr. 1/66, truall, me sipërfaqe 1266.6 m² dhe ndërtesë 183 m², ndodhur në zonën kadastrale 8150, Tiranë”; Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 48, datë 11.11.2015, për “Krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.49, datë 11.11.2015 për “Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës” dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I:

1. Kalimin e të drejtës së administrimit te Tirana Parking, me qëllim ofrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë, të sipërfaqeve që ndodhen brenda pasurive si më poshtë vijojnë:
 - a) Pasuria me nr. 7/6, e regjistruar në ZVRPP, Tiranë, në vol. 17, fq. 35, lloji i pasurisë “Shesh”, që ndodhet në zonën kadastrale nr. 8160, indeks harte TR- S- 12, me sipërfaqe totale trualli prej 6265 m², sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi.

- b) Pasuria me nr. 1/91, e regjistruar në ZVRPP, Tiranë, në vol. 57, fq. 70, lloji i pasurisë “Truall”, që ndodhet në zonën kadastrale nr. 8270, indeks harte TR-S-10, me sipërfaqe totale truall prej 6315 m²; sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi.
- c) Pasuria me nr. 1/66, e regjistruar në ZVRPP, Tiranë, në vol. 32, fq. 118, lloji i pasurisë “Truall”, që ndodhet në zonën kadastrale nr. 8150, indeks harte TR-P-12, me sipërfaqe totale truall prej 1266.6m² dhe sipërfaqe ndërtimore prej 183 m², sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi.
- d) Pasuria me nr. 6/83, e regjistruar në ZVRPP, Tiranë, në vol. 16, fq. 233, lloji i pasurisë “Rrugë, me sipërfaqe 146 m², sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi që ndodhet në zonën kadastrale nr. 8160, indeks harte TR-T-12, 13, rruga “Elbasanit”, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi
- e) Pasuria me nr. 7/102, e regjistruar në ZVRPP, Tiranë, në vol. 55, fq. 189, lloji i pasurisë “Truall, me sipërfaqe 2400 m², që ndodhet në zonën kadastrale nr. 8270, indeks harte TR-U-10, rruga “Dora D’Istria”, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi.
- f) Pasuria me nr. 1/340, e regjistruar në ZVRPP, Tiranë, në vol. 1, fq. 238, lloji i pasurisë “Rrugë, me sipërfaqe 8008 m², që ndodhet në zonën kadastrale nr. 8280, indeks harte TR-V- 10, rruga “”, Skerdilajd Llagami”, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi
- g) Pasuria me nr. 4/106, e regjistruar në ZVRPP, Tiranë, në vol. 60, fq. 200, lloji i pasurisë “Rrugë, me sipërfaqe 3440 m², që ndodhet në zonën kadastrale nr. 8270, indeks harte TR-T-11, S-12, rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, figuron në pronësi të Shtetit dhe pasuria me nr. 2/340, e regjistruar në ZVRPP, Tiranë, në vol. 2, fq. 215, lloji i pasurisë “Truall, me sipërfaqe 444 m², që ndodhet në zonën kadastrale nr. 8280, indeks harte TR-T-11, S-12, rruga “Lekë Dukagjini”, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kalimin e të drejtës së administrimit të Tirana Parking, me qëllim përdorimin për zyra për administratën, të pasurisë me nr.10/103, truall me sipërfaqe 366.8 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 230.8 m², që ndodhet në zonën kadastrale nr. 8370 me numër pasurie 10/103, indeks harte TR-N-12 sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Tirana Parking, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI